VENDIM
Nr.404, datë 20.5.2020

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIM URBAN SHESHI BORSH, HIMARË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim urban Sheshi Borsh, Himarë".
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Himarë.
3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 954 880 (nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 954 880 (nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i vitit 2020, i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin buxhetor "Planifikimi urban".
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare".
7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Himarë.
8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Himarë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit, Bashkia Himarë.
9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Himarë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, Bashkia Himarë, për pasurinë e shpronësuar.
10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Himarë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Himarë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista e pronarëve të pasurisë pronë private që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim urban Sheshi Borsh, Himarë".

Nr	Emër Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Rrethi	Sip. e ndërtimit (m^2)	Sip. e truallit (m^2)	Çmimi i ndërtimit (l/m^2)	Çmimi i truallit (l/m^2)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera Totale (lekë)	Shënime
1	Bashkëpronarët Bisha, Leka, Shimani, Beluli, Dibra, Huta, Vokopola, Lleshi, Xhaferaj	ZK. 1253	56/33/2	Sarandë, Borsh	___	**373.0**		2,560	___	954,880.00	954,880.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Sarandë me shkresën nr. 13021 prot., datë 15.01.2018. Pasuri e llojit "Truall".
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT											**954,880.00**	

Shënime

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM nr.514, datë 30.7.2014
2. Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen nga ZVRPP, Vlorë, me shkresën nr.13 prot., datë 15.1.2019